

NOTE INFORMATIVE

Tiranë, më 7.12.2023

Mbi parashtrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedim disiplinor të përcjellë për kompetencë nga KLGJ për magjistratin M.K.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka administruar dosjen e procedimit disiplinor ndaj M.K., gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i përcjellë pranë ILD-së për kompetencë, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 30.06.2023, si proces i nisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë, bazuar në Urdhrin nr. 4281/2, datë 17.07.2012 të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në ankesën e një subjekti bankar.

Nga analiza dokumentare e dosjes për identifikimin e elementeve juridike, si dhe fakteve apo rrethanave, të cilat duhet të trajtohen nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si organi përgjegjës të cilit i kanë kaluar kompetencat e organeve të mëparshme, si Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, apo Ministri i Drejtësisë për kryerjen e hetimit disiplinor, apo dhe fillimin e procedimit disiplinor, ka rezultuar se Ministri i Drejtësisë pas zhvillimit të procesit hetimor ka kërkuar nisjen e procedimit disiplinor dhe i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë të vendosë masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”. Pas paraqitjes së kërkesave për nisjen e procedimit disiplinor, Ministri i Drejtësisë ka kërkuar pezullimin e kërkesave për procedim disiplinor ndaj magjistratit Markelian Koça. Nga ana e tij, Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimet e dt. 14.02.2013 dhe 19.07.2013 në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka vendosur pezullimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit.

Në vlerësimin e ILD-së, pezullimi i procedimit disiplinor nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është një gjendje juridike, që pengon palët të vazhdojnë më tej procedimin disiplinor të filluar deri në rënien e shkakut për të cilën është marrë vendimi për pezullimin e tij. Për pasojë i ka përcjellë KLGJ-së, si organ të cilit i kanë kaluar funksionet e mëparshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën për të verifikuar rënien apo ekzistencën e shakut të pezullimit, si dhe marrjen e një vendimi të ndërmjetëm, në lidhje me rifillimin ose jo të procedimit disiplinor ndaj magjistratit. Më dt. 30.11.2023, KLGJ vendosi shfuqizimin e vendimeve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykata më të larta dhe vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magjistratit M.K. dhe dërgimin e akteve Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

ILD konstatoi se shkeljet disiplinore të pretenduara ndaj magjistratit M.K., të kryera në vitet 2009 dhe 2012, ishin parashkruar. Për shkak të kalimit të afatit ligjor, organi disiplinor nuk kishte më të drejtë të hetonte apo të vendoste masë disiplinore, në zbatim të parimit të sigurisë juridike. Për këtë arsye, ILD i kërkoj KLGJ-së mbylljen e procedimit disiplinor ndaj M.K. për shkak të parashkrimit të shkeljeve.